



Fatmir Guri është profesor i “Ekonomisë së Burimeve Natyrore dhe Mjedisit” në Universitetin Bujqësor të Tiranës. Ai ka një doktoraturë në Ekonomi (ekonomi bujqësore) nga Supagro Montpellier France dhe vazhdon të punojë në Departamentin e Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit.

Puna dhe përvoja e tij përfshin një periudhë post-doktorale në Institutin e Kërkimit të Komisionit Evropian në Sevilje të Spanjës. Interesat e tij kërkimore dhe publikimet përqëndrohen në ekonominë e tokës dhe në evoluimin e përdorimit të tokës në Shqipëri, si dhe

strategjinë e fermave bujqësore në zonën bregdetare në Shqipëri.

Një pjesë e rëndësishme e hulumtimeve të bëra nga Z. Guri, është përqendruar në procesin e kolektivizimit të tokës në Shqipëri si dhe efektet mbi produktivitetin e sistemeve bujqësore. Hulumtimi i tij merret edhe me çmimet e tokës dhe faktorët që ndikojnë drejtpërdrejtë në çmimin e tokës në zonat bujqësore, ndikimin e përdorimit alternativ të tokës në çmimet e tokës etj. Një fushë tjetër e kërkimit lidhet me produktivitetin e sistemeve bujqësore dhe tipologjinë e sistemit bujqësor në Shqipëri.

Ai është anëtar i rrjeteve të ndryshëm kërkimor për sistemet bujqësore dhe zhvillimin rural në zonat mesdhetare (RAFAC), Foncimed - për çështjet e tokës në zonat e Mesdheut, Modam etj. Ai është anëtar i bordit të Foundation “Assembly of the citizens of the Mediterranean areas”. Që nga viti 2015 është anëtar i Bordit të Akreditimit të Arsimit të Lartë (ish Këshilli) i Shqipërisë.